

V E N D I M
Nr.314, datë 30.6.1993

**PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË MINISTRITË, DHE
INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT LOKAL**

Në zbatim të ligjit nr.7724, datë 22.6.1993 "Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit",
Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në ministritë e në institucionet e tjera qendrore dhe në organet e pushtetit lokal koha e punës është 8 orë në ditë. Puna fillon në orën 7.00 dhe mbaron në orën 15.00.

2. Koha javore e punës është 40 orë, të ndara në 5 ditë pune, nga dita e hënë deri ditën e premte. Niveli i pagës mujore të çdo punëmarrësi nuk ndryshon. Për efekt të llogaritjes së pagës mujore muaji merret mesatarisht me 21 ditë efektive pune.

3. Për punën e kryer para dhe pas kohës së punës në ditët e zakonshme, si dhe në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare, punëmarrësve në sektorin e shërbimit e të mirëmbajtjes, daktilografistëve, shumëfishuesve, portierëve, rojave, shoferëve, centralistëve e magazinierëve u jepet pushim ose u paguhet deri 240 orë në vit.

Pagesa për punën e kryer në mbikohë bëhet me urdhër të titullarit si vijon:

a) Për mbikohën para dhe pas kohës së punës paguhet shtesë prej 25 për qind të pagës.

b) Për mbikohën në ditët e diela dhe të festave zyrtare paguhet shtesë prej 50 për qind të pagës.

4. Punëmarrësve që përcaktohen në pikën 3 të këtij vendimi, kur me urdhër të titullarit punojnë ditën e shtunë, u jepet pushim ose u paguhet puna e kryer si në ditët e zakonshme.

5. Punëmarrësve të ministrive e institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal që nuk përcaktohen në pikën 3 të këtij vendimi, u quhet mbikohë vetëm koha e punës mbi kohën normale, për plotësimin e detyrave të ngarkuara nga titullari.

Pagesa në këto raste bëhet me urdhër të titullarit në masën që përcaktohet në pikën 3 të këtij vendimi.

6. Pushimi vjetor i pagueshëm për punëmarrësit e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal është 12 deri 21 ditë pune.

Diferencimi për efekt të moshës, vjetërsisë së përgjithshme në punë dhe llojit të punës bëhet duke shtuar ditë pushimi mbi pushimin minimal, që është 12 ditë, sipas ndarjeve të mëposhtme:

a) Moshë (në vjeç)	Ditët që shtohen
-----------------------	------------------

deri në 30	0 ditë
mbi 30 deri 40	1 ditë
mbi 40 deri 50	2 ditë
mbi 50	3 ditë

b) Vjetërsia në punë (në vite)	Ditët që shtohen
-----------------------------------	------------------

deri në 5	0 ditë
mbi 5-15	1 ditë
mbi 15-25	2 ditë
mbi 25	3 ditë

c) Lloji i punës (në grupe)	Ditët që shtohen
--------------------------------	------------------

Grupi IV	0 ditë
Grupi III	1 ditë
Grupi II	2 ditë
Grupi I	3 ditë

Në grupin IV përfshihen punëmarrësit që përmenden në pikën 3 të këtij vendimi.

Në grupin III përfshihen specialistët, shefat e sektorëve ose seksioneve, kryetarët e degëve dhe punëmarrësit e tjerë të një shkalle me ta në pagë.

Në grupin II përfshihen zëvendësministrat, drejtorët e drejtorive, kryetarët e këshillave të rretheve e bashkive dhe funksionarë të tjerë të një shkallë me ta në pagë.

Në grupin I përfshihen Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe funksionarë të tjerë të lartë të një shkalle me ta në pagë.

Pushimi vjetor për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, është 18 ditë pune.

7. Në varësi nga lloji i punës (ndarë në grupe sipas funksioneve në organikë) punëmarrësit marrin pushim plotësues të pagueshëm si vijon:

Lloji i punës	Ditët e pushimit plotësues (në grupe)
Grupi IV	0 ditë
Grupi III	2 ditë
Grupi II	5 ditë
Grupi I	8 ditë

Ndarja në grupe është sipas pikës 6 të këtij vendimi.

8. Punëmarrësit kanë të drejtë për pushim të jashtëzakonshëm të papagueshëm deri në 3 muaj në vit, kur ky nuk i sjell dëm punës, në këto raste:

- vdekje dhe martesë në pjestarë të familjes;
- përkujdesje për anëtarë të familjes;
- fatkeqësi në familje.

Pushimi i jashtëzakonshëm i papagueshëm jepet vetëm me urdhër të titullarit.

9. Efektet financiare për vitin 1993 të përballohen nga çdo ministri, institucion tjetër qendror dhe organ i pushtetit lokal brenda fondeve të miratuara.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi